

HALIL LAZE

BIBLIOTEKA
SHTETIT

SH-32
L 34

MË FAL FLORA



SKICA DHE TREGIME

891.P83-32

S

L 34

HALIL LAZE


R

MË FAL,
FLORA

36056

57283

SKICA
DHE
TREGIME



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

MË FAL, FLORA

Ai përplasi derën dhe hyri pa trokitur brenda. Flora i doli përpara dhe deshi t'i merrte kapotën. Ai u ul mbi minder pa u zhveshur.

— Si shkove sot? — e pyeti.

— Çka! — ja preu shkurt Kujtimi.

— U lodhe?

Ai nuk u përgjegj.

— Do të hash?

— Jo, kam ngrënë në repart.

Në dhomë ra përsëri heshtja. Një heshtje e rëndë dhe torturuese për të dy, një heshtje që kishte ditë që zotëronte në shtëpi.

Kujtimi kishte vendosur shumë herë të bisedonte me Florën. Donte t'ja thoshte të gjitha. Bile i kishte menduar një për një edhe fjalët që do t'i thoshte: si do t'ja niste, si do t'u përgjigjej pyetjeve të saj dhe si do t'ja priste me fjalën e fundit.

Fjalën e fundit! Kjo e torturonte Kujtimin. Këtë nuk mund ta bënte. Sa hynte brenda, ndeshte në shikimin pyetës e të habitur të Florës dhe nuk guxonte të hapte gojën. Ai ishte mësuar aq shumë me vështrimin e saj, sa i qe bërë pjesë e pandashme e jetës



së tij. Tani në shikimin e saj lexonte një pyetje, vetëm një pyetje që kishte të bënte me qëndrimin e tij. Por ai nuk vendoste t'i thoshte asgjë.

U mbështet në jastëkun e minderit dhe ndezi një cigare. Flora i afroi taketuken dhe shkoi pranë so-

bës. Ai e shikonte nga perdja e aneksit konturin e saj në profil. Ju kujtua takimi i tyre i parë.

Atë ditë binte shumë shi. Ai e humbi shpresën edhe pse ajo i kishte premtuar.

— Më fal, se u vonova, — i tha ajo dhe ktheu kokën nga ora e madhe e qytetit. Ai për herë të parë e pa aq afër. Ajo pamje ju skicua në kujtesë dhe e kuptoi se kështu do ta kujtonte përherë: të shqetësuar për vonesën dhe me shikimin nga ora e qytetit. Sa herë që mbyllte sytë për të sjellë në mend Florën, i dilte përpara po ai kujtim i ëmbël.

— Ta bëra pak të rëndë, — i foli Flora, duke i zgjatur filxhanin me kafe.

Ai zgjati dorën dhe filxhani u drodh lehtë në pjatë, si ditën e fejesës, kur ajo i nxori për herë të parë pijen.

«Kaq e vështirë qenka?» — mendoi dhe pas aq ditësh e pa drejt e në sy Florën. Për disa çaste nuk ja ndanë sytë njëri tjetrit. Asaj ju drodhën lehtë buzët dhe në cepat e syve i shkëlqyen disa bulëza lotësh. Kishte kohë që Kujtimi nuk e shikonte në sy. Qëndrimi i tij e torturonte dhe e fuste në njëmijë mendime. Ai i pa ato bulëza lotësh dhe u bë gati të çohet e ta merrte në krahë.

Instinktivisht u çua përgjysmë. Ajo hodhi një hap përpara. Edhe pak dhe ata do të përfundonin në krahët e njëri tjetrit, por... atij i shkrepri para syve si rrufe biseda e zymtë në kafenenë në fund të qytetit.

U ngrit rrëmbimthi në këmbë dhe filloi të shetisë nëpër dhomë. Në kokë i kumboi përsëri biseda e asaj nate në klubin e qytetit. Ato fjalë i drejttoheshin Kujtimit.

— Po e pate gruan të bukur, ke betanë brenda.

— Turpin, thuj.

— Mirë e the, turpin.

— Sa keq, është alamet djali.

— E njeh ti?

— Pak.

— Edhe ai ka faj.

— E ç'faj ka ai i shkreti? Ku e lë detyra të ruajë gruan.

— Të mos e kishte futur në punë. Në mos njëri, tjetri do t'ja prishte mendjen.

— Se mos ka dashur ai i ziu. Kush i ndalon dot femrat sot.

— S'i ndalon, s'i ndalon, po burri është burrë. Ai i ka dhe ai duhet t'i mbajë frenat. Do bësh kështu si them unë dhe pikë. Mirë? Në mos prapa diellit!

— Avash, se e ke prapa dhe të dëgjon.

— Kë?!

— Shëët!.. Është këtu.

— Sikur nuk e di ai.

— I zoti e merr vesh i fundit.

Ai ndjeu përnjëherësh një zbrazëtirë të tmerrshme. Gjithshka ju shpërnda dhe ju ngatërrua. Nuk i besohej të kishte dëgjuar një bisedë të tillë. Ktheu kokën nga tavolina ku u zhvillua biseda, por ajo ishte bosh. Mbi xhamin e saj ishte shpërndarë hiri i cigareve. Taketukja e mbushur plot me bishta cigari ju duk si një minë, së cilës të panjohurit i kishin hequr siguresën dhe ajo nga çasti në çast do të pëlciste.

Qysh atë ditë ju prish qetësia.

Florën e shikonte me ftohtësi e me dyshim, por asaj nuk i tha asgjë. Donte ta zgjidhte vetë këtë lëmsh të ngatërruar. Donte të sigurohej, të gjente fakte bindëse. Por nuk ishte e lehtë.

Tani priste t'i vinte në shtëpi Bashkimi. E kishte epror, por kjo nuk i kishte ndaluar të lidhnin një

miqësi të vërtetë ushtarake. Bashkimi që i pari që vuri re ndryshimin në gjendjen shpirtërore të shokut të vet. Dhe më në fund Kujtimi ja tregoi të gjitha. Bashkimi nuk reagoi fare në ato çaste. Nuk e ndërpreu asnjëherë dhe, kur Kujtimi mbaroi, heshti për një kohë të gjatë. U mendua thellë, ashtu siç e kishte zakon para se të merrte një vendim.

— Jam i bindur se ke rënë viktimë e thashethemeve, — ja kishte nisur ai bisedës. — Ta them këtë me bindjen më të plotë, si komunist dhe si shok. Unë e njoh mirë Florën. Ajo la qytetin e madh, la familjen dhe rrethin shoqëror, la punën dhe të ndoqi ty nga prapa pa më të voglin ngurrim. Erdhi këtu dhe filloi nga puna, se ajo është rritur me të. Është mësuar të punojë dhe t'i japë shoqërisë. Ti ke bërë gabim të madh që u ke vënë veshin fjalëve që dëgjove. Florës nuk duhet t'i thuash asgjë, pa u takuar dhe një herë bashkë.

Dhe ja, tani Kujtimi priste nga çasti në çast që të hynte Bashkimi. Nuk e kuptonte pse e kishte lënë këtë takim në shtëpi dhe në një orë që Flora ishte brenda.

Trokiti dera dhe Bashkimi hyri bashkë me dy shokë të tjerë civilë. Kujtimi shtangu. Njëri prej tyre ishte një nga ata burrat që bisedonin në kafene. U përshëndetën dhe u ulën. Bashkimi ishte në humor dhe shumë i qetë. Kujtimi nuk dinte si të vepronte. Burri i kafenesë rrinte si mbi gjemba në gjysmë të karriges dhe dukej sikur nga çasti në çast do të nisej me vrap.

— U vonova ca, se isha në një mbledhje. Më kishte ftuar drejtori i ndërmarrjes, shoku Skënder, besoj se njiheni, — tha Bashkimi dhe prezantoi burrin që kishte në krah.

— Në mbledhje do të ishte mirë të kishit ardhur edhe ti me Florën, — tha drejtori.

— Ne? — pyeti Kujtimi.

— Shkova unë, se e dija që ti ishe i lodhur, — tha Bashkimi dhe i shkeli syrin Kujtimit.

— Po ky shoku, cili është? — pyeti pa të keq Flora.

— Ai do të prezantohet vetë, — tha drejtori dhe ja bëri me kokë burrit të kafenesë që të fliste.

— Mua më ka ngarkuar kolektivi i ndërmarrjes, që të vij këtu dhe t'ju kërkoj të falur, se kam thënë disa fjalë jo të hijshme, — murmuriti ai nëpër dhembë.

— Për ty i ka thënë këto fjalë, — e sqaroi Bashkimi Florën që shikonte e habitur.

— Përse i keni thënë ato fjalë? — pyeti me padurim dhe pa e fshehur urrejtjen Kujtimi.

— Po ja. E pashë një herë këtë shoqen tuaj me një djalë të ri, nën një çadër, dhe thashë se...

— E njihje ti atë djalin? — pyeti përsëri Kujtimi.

— Atëhere nuk e njoha, prandaj edhe dyshova, por më vonë ju pashë një ditë të dyve në kinema. Ju atëhere ishit veshur civil, si atë natë, dhe e kuptova se isha gabuar. Por unë e kisha thënë fjalën dhe, nga forca e zakonit, më erdhi rëndë ta merrja prapa.

— Ose, më saktë, nuk të leverdiste, se je mësuar me të tilla muhabetete dhe pa to nuk të pihet as kafeja, — shtoi Bashkimi.

— Ja si qenka puna, — tha me gjysmë zëri Kujtimi dhe shikoi me dhembshuri Florën, që i ishte ulur në krah dhe dëgjonte me vëmendje bisedën e çuditshme të burrave.

Flora rrinte si e hutuar. Kujtimi u kthye dhe e kapi lehtë nga duart.

— Mos u çudit, Flora, kjo ishte një hije që erësoi për pak kohë dashurinë tonë. Më fal, Flora, ti nuk ke asnjë faj!

PRANË RRJEDHËS SË LUMIT

Vendi ishte shumë i bukur. Edhe Juana ishte shumë e bukur. Nga mali uji rridhte i pastër dhe i rrëmbyeshëm. Unë doja t'i krahasoja sytë e Juanës me blunë e burimit malor, por krahasimi nuk më dukej i përshtatshëm. Ajo qeshte dhe pinte me etje verën e bardhë. Dukej shumë e lumtur. Vallë, pse ishte aq e qeshur Juana? Unë mundohesha të lexoja në sytë e saj burimin e buzëqeshjes. Por ajo nuk më linte të qetë. Unë mendoja, por kisha frikë se mos më lexonte mendimin. Inxhinieri, si gjithmonë, aprovonte dhe duartrokiste çdo mendim e veprim të saj.

— Dua të freskohem, — tha Juana.

— Uji i lumit është i freskët, — i tha inxhinier Skënderi.

— Më dhemb pak koka. Dua të freskohem, — tha ajo e vendosur dhe u çua.

— Unë s'mund të vij, — tha me keqardhje inxhinieri. — Ti e di që kam kaluar një pleurit të rëndë.

— Do të më shoqërojë Iliri. Ky është ushtarak dhe nuk ka frikë nga uji i ftohtë i lumit. Apo jo, Ilir? — më pyeti mua.